



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 677/24
Dt. 04.09.2024

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 43 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe në pajtimit me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe propozim dhe të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe ZPP-së, më dt. **04.09.2024** merë:

V E N D I M

1. Emërohen Menaxherë të kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **” Ri-Ndërtimi i rrugës së rendit të katërt Vesekofc-Baqkë” Aneks Kontratë, me numër të prokurimit: VU644-24-8186-5-3-5 dhe numër të brendshëm të prokurimit VU644-23-138-521, si vijon :**

z. Islam Latifi, emërohet menaxher i kontratës.

z. Benjamin Shala, emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherëve të Kontratës,

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :

- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kycet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim me Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës, Menaxheri i Projektit do të lëshoj Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësitë të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

- Në baza mujore dhe në bazë të gjendjes së konstatuar Menaxheri i Kontratës do të hartoi Raport mujor në të cilin do të përshkruhet gjendja faktike nëse çdo pajisje ka funksionuar në rregull dhe nëse shërbimet janë ekzekutuar në përputhje me kushtet e Kontratës dhe Porosinë. Nëse konstaton të meta dhe/ ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve do të kërkoi mënjanimin e tyre duke i

caktuar Kryesit të Shërbimeve - Kontraktuesit afatin për mënjanimin e parregullsive. Nëse Menaxheri konstaton se nuk ka të meta dhe / ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve dhe përmbushjen e obligimeve kontraktuese, atëherë do të do të përpiloi – lëshoi një Raport të veçantë mbi përfundimin e shërbimeve të Porositura në baza mujore, të cilin një kopje, të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës, në afatin më të shkurtë kohorë do t'ia dërgoi Kryesit të Shërbimeve, ndërsa një kopje Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, me qëllim të procedimit të mëtejme

- kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësive të përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

Përgjegjës dhe funksionet e Mbikëqyrës të Menaxherit të Projektit/ Kontratës, janë me sa vijon :

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
 - administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual të kontratës, dhe
 - rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësim të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.
3. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë dhe Operatorit Ekonomik: " Kopshti " SH.P.K., Rr. Isak Halili, -42000, VUSHTRRI, Kosovë, me Numri fiskal: 600297560, cilën e përfaqëson z. Fatmir Kajtazi.

Kopje: Menaxheri i Kontratës;
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës;


Drejtorisë së Prokurimit;
Drejtorit të Njësisë Kërkuese

Për
Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-24-8186-5-3-5/C942
14 Nr. 676/24
Dt. 04.09.2024

ANEKS KONTRATË PUNE/SHËRBIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe
2. “ **Kopshti** “sh.p.k. me seli në Vushtri, me ARBK : 810142430 , të cilën e përfaqëson **z. Fatmir Kajtazi**, në tekstin e mëtejme: **KRYESI I PUNËVE**,

janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për ekzekutimin e shërbimeve dhe / ose punëve shtesë, si në vijim: : “
ndërtimi I rrugës së rendit të IV-të Veskofc – Baçkë“, me numër identifikues:

Nr. I prokurimit	VU644	2	4	81	8	6	5	3	5
Nr. I brendshëm	644	2	3	1	3	8	5	2	1/5

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : ekzekutimi i punimeve shtesë të paraqitura gjatë ekzekutimit të punimeve në projektin : **ndërtimi i rrugës së rendit të IV-të Veskofc – Baçkë** , në pajtim dhe në sasi si në Specifikimin Teknikë pjesë përbërëse e kësaj Aneks Kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit. Afati i fillimit të punëve është **1 (një) ditë pas lidhjes së Aneks Kontratës**, ndërsa ekzekutimi i punëve dhe / ose shërbimeve duhen të përfundohen në afatin, jo më gjatë se **5 ditë pas datës së fillimit të ekzekutimit të Punëve dhe / ose Shërbimeve**.

1.3 Vendi i ekzekutimit të punimeve është: **rruga Veskofc – Baçkë**, sipas Kontratës bazë nr. **1378/23 dt. 04.12.2023**

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **1,799.50€ (njëmijshatatqindnëntdhjetenëntë/50 Euro)**.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Mjetet për realizimin e projektit janë siguruar nga fondet e Komunës së Vushtrrisë.

3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit teknik të Punëve dhe / ose shërbimeve të ekzekutuara të konfirmuara nga Komisioni i Pranimit Teknik i emëruar nga ZKA i A.K.. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Komisioni i Pranimit Teknik do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për punimet dhe / ose shërbimet e përfunduara dhe / ose pranuar.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti respektivisht cilësia e punëve dhe / ose shërbimeve duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni, përmes : Polisa e Sigurimit e lëshuar nga një bankë apo kompani e sigurimeve e licencuar nga BQK me afat validiteti prej 13 muaj, pas pranimit të punëve dhe / ose shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,10% në ditë të vlerës së punëve dhe / ose shërbimeve të pa përfunduara/dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.



Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);





3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:

“ Kopshti “sh.p.k. – Vushtrri

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë

Emri:	Fatmir Kajtazi	Emri:	Ilmi Azemi
Pozita:	drejtor	Pozita:	drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	04.09.2024	Data:	04.09.2024
Vula:		Vula:	

Numri i prokurimit: VU644-23-10618-5-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-23-138-521 Titulli: Ri-Tender Ndërtimi i rrugës së rendit të katërt Vesekofc- Baqkë

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8% apo 18%. Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
Vërejtje: Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Paralogaritura. Punëkryesi duhet t'ia prezantojë përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim. Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjuhë funksionale. Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshijë certifikatat e kualitetit dhe të standardëve.									
I	Ndërtimi i rr.Vesekoc - Baqka (me zhavorr)								
1	Pastrimi i trases nga shkurret, dhe drunjetm, materjali i deponuar të bartet në largësi 10km. Në raste specifike (me urdher të investitorit apo organit mbikqyrës)	m'	230.00	0.55	18.00	0.65	126.69	22.81	149.50
2	Hapja e I kanaleve kulluse në formë trapezi me dimensione 60*80*2.2 m për largimin e, rrjedhave ujorë të cekta dhe rrekeve nga mbeturinat, dhe rregullimi I tyre nga rreshitjet e dheut, materiali I gërmuar te transportohet ne vendin e caktuar nga org.identifikim e ben organi mbikqyres Hapja e kanlit të bëhet në formë trapezi	m'	230.00	0.85	18.00	1.00	194.92	35.08	230.00
3	Gërmimi i gjërë i dheut të kategorisë: III dhe IV, V..me makinë për rregullimin e trases se rruges ne thellesi mesatarer h=0.2-3.5m. b=7.6m materiali i gërmuar duhet të largohet në deponim më të afërt. Ne qmim te llogaritet nivelizimi dhe ngeshja pas gërmimit. Llogaria në m3 te dheut te gërmuar	m³	500.00	1.69	18.00	2.00	847.46	152.54	1000.00
4	Furnizimi me material natyral, shtrirja dhe ngeshja deri ne masen e duhur e shtreres se materialit natyral 0 -130 mm në trashesi mes t=30.0 cm ne trasen e rruges te kategorisë IV. Llogaria ne m3 te materialit natyral te ngeshur	m³	105.00	3.39	18.00	4.00	355.93	64.07	420.00
							1,525.00	274.50	1,799.50

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)

EMRI I OE:

Kopshti SH.P.K

Numri i prokurimit: VU644-23-10618-5-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-23-138-521 Titulli: Ri-Tender Ndërtimi i rrugës së rendit të katërt Vesekofc- Baqkë

EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT	TË OË:	Fatmir Kajtazi
NËNSHKRIMI:		
DATA:		20.08.2024
VULA:		

